

Vendim nr. 171, datë 28.05.2026

V E N D I M

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (A) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ARBEN CARA, përfaqësuar nga avokati Aleksandër Ndrejaj, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 69, datë 15.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 52, datë 12.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1932, datë 11.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 31, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 186, datë 09.07.2020 (*procedimi penal nr. 186/2020*) ndaj kërkuesit, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal (*KP*) dhe, më pas, i ka njoftuar akuzën për këtë vepër. Sipas akuzës, kërkuesi kishte përfutur në mënyrë të parregullt një shumë 6.000 euro, e cila i ishte dhënë nga shtetasi S.D., me qëllim që bashkëshortja e tij, shtetasja M.M., gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare të ndryshonte masën e sigurimit të caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ndaj shtetasit O.B., konkretisht “zbutjen” e saj nga “Arresti në burg” në “Garancia pasurore”, ndryshim për të cilin trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë edhe shtetasja M.M, kishte disponuar në favor.

2. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për gjykimin e kërkuesit, i cili është akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të KP-së. Me vendimin nr. 37, datë 07.02.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal, në ngarkim të kërkuesit, për veprën penale për të cilën ishte akuzuar.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 69, datë 15.12.2022 (*vendimi nr. 69/2022*) GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, për veprën penale për të cilën ishte akuzuar dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 52, datë 12.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të nr. 69/2022 të GJKKO-së Shkallës së Parë.

5. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1932, datë 11.12.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

6. Në datën 01.04.2026 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

7.1.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi i) GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar ndryshimin që organi i akuzës u ka bërë fakteve gjatë konkluzioneve përfundimtare, çka është pranuar edhe nga GJKKO-ja e Apelit, në cenim të parimit të sigurisë juridike për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit; ii) GJKKO-ja e Apelit ka marrë një rol “aktiv”, duke rikualifikuar faktet nga marrje e përfitimit të paligjshëm në pranim të ofertës për përfitim të paligjshëm dhe i ka dhënë akuzës një kuptim tërësisht të ndryshëm nga ai i pretenduar nga organi i akuzës. Ky ndryshim i elementit objektiv nuk është thjesht një emërtim i ri, por fakt i ri material, për të cilin kërkuari nuk është njoftuar dhe nuk i është dhënë mundësia të mbrohet.

7.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi GJKKO-ja e Apelit nuk e ka pranuar kërkesën për të riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe të pranojë si prova: i) *hardisk-un* me pamjet origjinale të filmimeve të ambienteve të hotel “Pazar”, si dhe 10 foto të printuara, ku tregohen pamje të datave 28, 29 dhe 30 korrik, kur pretendohet se ka ndodhur ngjarja; ii) aktet e ekspertimit grafik nr. 8.1, datë 22.08.2022, nr. 8.2, datë 23.08.2022, nr. 8.3, datë 24.08.2022 dhe nr. 8.4, datë 25.08.2022; iii) kryerjen e një akti ekspertimi të ri grafik; iv) urdhrat për krijimin e grupeve të vëzhgimit.

7.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, I.P. dhe A.B., që kanë shqyrtuar rekursin e tij, kanë qenë njëkohësisht edhe pjesë e trupit gjykues të kësaj gjykate që ka shqyrtuar kërkesa

të tjera të palëve gjatë hetimeve paraprake. Për këtë shkak, në datën 31.10.2025 ka paraqitur kërkesë/informacion nëpërmjet të cilit ka informuar se ata gjyqtarë kishin papajtueshmëri për shqyrtimin e çështjes së tij.

- 7.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është arbitrar dhe i paarsyetuar. Ajo gjykatë ka dhënë vlerësimin e saj për rekursitet vetëm me dy faqe arsytim, duke konfirmuar argumentet e dhëna nga GJKKO-ja e Apelit, pa mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me të gjitha shkaqet e rekursitet.
- 7.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë, duke e konsideruar takimin si provë të mjaftueshme për ekzistencën e marrëdhënies korruptive, e kanë zhvendosur barrën e provës nga akuza tek i pandehuri. Në faktet objekt akuze flitet për përfitim të paligjshëm një ditë para gjykimit të çështjes në apel, por në asnjë provë ose fakt historik të ngjarjes nuk citohet që po premtohet një përfitim i paligjshëm. Në vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit nuk është cituar asnjë komunikim që të provojë që të jetë propozuar një shumë e caktuar si premtim për kryerjen e një veprimi të kundërligjshëm nga ana e kërkuarit. Po kështu, nga provat ka rezultuar se përfitimi i paligjshëm është dhënë në datën 28.07.2020, ndërkohë që GJKKO-ja e Apelit argumenton se oferta për përfitim të paligjshëm është bërë në datën 29.07.2020. Kjo gjykatë ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme faktet, duke shmangur provat e plota ku flitet për kalim shumash monetare nga avokati te gjyqtari i çështjes. Nga përgjimi ka rezultuar se gjyqtari O.Xh. kishte marrë shumën 7.500 euro nga avokatja E.B. për të liruar klientin e saj të bashkarrestuarin A.M. dhe po e njëjta avokate, në të njëjtën mënyrë, kishte marrë përsipër të lironte edhe klientin e avokatit S.D., shtetasin O.B. Pra, në rastin konkret provat janë të qarta dhe të plota, si dhe mekanizmi i ngjarjes nëpërmjet dhënies së parave dhe përfitimi i paligjshëm nga avokatja te gjyqtari O.Xh.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.12.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 01.04.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuetit parashtrihen në kuadër të *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në aspekt të (*së drejtës për t’u mbrojtur, parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*), si dhe të *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës.

11. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur, pasi i) GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar ndryshimin që organi i akuzës u ka bërë fakteve gjatë konkluzioneve përfundimtare, çka është pranuar edhe nga GJKKO-ja e Apelit, në cenim të *parimit të sigurisë juridike* për sa i përket zbatueshmërisë së ligjit; ii) GJKKO-ja e Apelit ka marrë një rol “aktiv”, duke rikualifikuar faktet nga marrje e përfitimit të paligjshëm në praninë të ofertës për përfitim të paligjshëm dhe i ka dhënë akuzës një kuptim tërësisht të ndryshëm nga ai

i pretenduar nga organi i akuzës. Ky ndryshim i elementit objektiv nuk është thjesht një emërtim i ri, por fakt i ri material, për të cilin kërkuesi nuk është njoftuar dhe nuk i është dhënë mundësia të mbrohet.

12. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Lidhur me shkakun e parë të paraqitur nga kërkuesi, Kolegji evidenton se Prokuroria e Posaçme ka kërkuar gjykimin e kërkuesit për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të KP-së. Në përfundim të gjykimit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale për të cilën ishte akuzuar. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar edhe cenimin e së drejtës së mbrojtjes, me argumentin se në konkluzionet përfundimtare organi i akuzës ka bërë ndryshimin e fakteve penale. Në lidhje me këtë pretendim, në analizë të akteve të fashikullit të gjykimit, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se në parashtrimin e rrethanave të faktit për çastin e dorëzimit të përfitimit të paligjshëm dhe saktësimin e personit që ka bërë dorëzimin fizikisht të këtij përfitimi drejtpërdrejt kërkuesit, prokurori nuk ka ndryshuar akuzën në kuptim të nenit 372 të KPP-së e nuk ka vepruar sipas parashikimeve të neneve 373 ose 374 të KPP-së. Po sipas asaj gjykate, edhe çmuarja e faktit penal nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk rezulton të jetë rënduar për të pandehurit e këtij gjykimi në kuptim të nenit 375, pika 2, të KPP-së. Në këtë kuptim, sipas gjykatës së apelit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë faktit penal një cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori në aktin e njoftimit të akuzës, por brenda së njëjtës “veshjeje ligjore”, sipas parashikimeve të neneve 319 dhe 319/ç të KP-së, ka çmuar ndryshe në drejtim të elementeve që lidhen me çastin e dorëzimit të shumës së përfitimit të paligjshëm (datën e dhënies së kësaj shume) dhe personin që i është dorëzuar fizikisht kjo shumë. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në këtë kuptim, në mungesë të ndryshimit të akuzës sipas parashikimeve të mësipërme ligjore, akuza në ngarkim të të pandehurve të këtij gjykimi konsiderohet e pandryshuar, e njëjtë me atë që parashtrohet në aktin e njoftimit të akuzës, në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në

vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, pavarësisht se prokurori në diskutimin përfundimtar ka specifikuar ndryshe elementet që lidhen me çastin e dorëzimit të përfitimit të paligjshëm dhe personat që kanë dorëzuar ose marrë fizikisht këtë përfitim të parregullt. Po sipas GJKKO-së së Apelit, elementi i anës objektive në lidhje me formën e konsumimit të aktit korruptiv sipas parashikimeve të nenit 319 të KP-së mbetet ai i dhënies së përfitimit të paligjshëm, ndërsa sipas parashikimeve të nenit 319/ç të KP-së mbetet po në formën e marrjes së përfitimit të paligjshëm (*shih faqet 29 dhe 30 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Më tej, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit, duke mos konstatuar asnjë shkelje të karakterit ligjor nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së (*shih paragrafin 27 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

14. Të njëjtin qëndrim Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur edhe për sa i përket shkakut të dytë të paraqitur në ankimin kushtetues individual, *cenimit të së drejtës së mbrojtjes*, konkretisht pretendimit të kërkuesit se GJKKO-ja e Apelit ka marrë një rol “aktiv” duke rikualifikuar faktet nga marrje e përfitimit të paligjshëm në pranim të ofertës për përfitim të paligjshëm dhe i ka dhënë akuzës një kuptim tërësisht të ndryshëm nga ai i pretenduar nga organi i akuzës. Gjykata e Lartë e ka gjetur të drejtë qëndrimin e GJKKO-së së Apelit se për të pasur veprën penale të korrupsionit mjafton që të provohet kryerja e saj në një prej formave të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të KP-së, përkatësisht premtimi, propozimi ose dhënia (neni 319 i KP-së) dhe kërkimi, marrja e një përfitimi të parregullt, pranimi i një premtimi ose oferte për një përfitim të parregullt (neni 319/ç të KP-së); që të ekzistojë vepra penale e korrupsionit pasiv mjafton të provohet se subjekti i posaçëm, në rastin konkret gjyqtari, të ketë vepruar nën ndikimin e një përfitimi të paligjshëm ose që sjellja e tij, kryerja ose moskryerja e detyrës apo e funksionit të tij të ketë qenë e kushtëzuar nga përfitimi i parregullt; për të pasur veprën penale të korrupsionit pasiv, sipas parashikimeve të nenit 319/ç të KP-së, nuk ka rëndësi të provohet çasti i marrjes së parave, por mjafton të provohet që sjellja e subjektit të posaçëm, kryerja ose moskryerja e detyrës apo funksionit të tij, ka qenë e ndikuar ose e kushtëzuar nga përfitimi i parregullt, pra që subjekti të ketë pranuar ofertën e propozuar, pavarësisht momentit se kur e ka marrë fizikisht shumën monetare të përfitimit të paligjshëm. Pra, për ekzistencën e veprës penale të korrupsionit pasiv nuk ka rëndësi çasti se kur është marrë fizikisht përfitimi i paligjshëm, ashtu sikundër nuk ka rëndësi as personi që e ka dorëzuar efektivisht mitën te gjyqtari. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka

vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit u ka dhënë përgjigje shteruese, të bazuara në prova, edhe këtyre pretendimeve të kërkuarit (*shih faqen 53, paragrafi 27, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

15. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuari ka pasur dijeni për veprën penale për të cilën është akuzuar si në aktin e njoftimit të akuzës, ashtu edhe në kërkesën për gjykim, duke pasur kështu të gjitha mundësitë për të ushtruar mbrojtjen e tij si gjatë gjykimit në shkallë të parë, ashtu edhe në apel. Po kështu, Kolegji vëren se, GJKKO-ja e Apelit, mbi të njëjtat fakte objekt akuzë, ka analizuar anën objektive të veprës penale për të cilën ishte akuzuar kërkuari, çka është vlerësuar e drejtë edhe nga Gjykata e Lartë. Kolegji vlerëson se në arritjen e këtij përfundimi GJKKO-ja e Apelit ka vepruar brenda kompetencave të saj, të parashikuara nga neni 425, pika 1, i KPP-së. Për më tepër, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë kthyer përgjigje këtij pretendimi, arsyetim i cili nuk rezulton të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur për këtë shkak është haptazi i pabazuar.

16. Në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, me pretendimin se GJKKO-ja e Apelit nuk ka pranuar kërkesën për të riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe të pranojë si prova aktet (*shih paragrafin 7.2 të vendimit*).

17. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Lidhur me bazën ligjore të rastit objekt shqyrtimi kushtetues, Kolegji vëren se neni 427, pika 1, i KPP-së parashikon se kur një palë në aktin e apelit kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata, në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gjyqësor.

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe, në lidhje me to, ka vënë në dukje se kërkesa e kërkuarit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, me qëllim që t'i mundësohet prokurorisë të provojë një fakt që e ka ngritur vetëm në diskutimin e saj përfundimtar, nuk

përfshihet në asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 427 i KPP-së. Sipas asaj gjykate, faktet e pranuar nga gjykata e posaçme e shkallës së parë në drejtim të çastit të dorëzimit të mitës dhe të personit që ka dorëzuar ose marrë fizikisht mitën, duke qenë rrjedhojë e analizës dhe çmuarjes së provave nga ajo gjykatë, përbëjnë objektin e këtij shqyrtimi gjyqësor mbi bazën e ankimit të të pandehurve të këtij gjykimi. Bazueshmëria në ligj dhe në prova e vendimmarrjes së GJKKO-së së Shkallës së Parë, për pjesën që ka pranuar si të provuar gjendjen e fakteve, sikundër parashtrohet në diskutimin përfundimtar të prokurorisë, do t'i nënshtrohet kontrollit të kësaj gjykate mbi bazën e të njëjtave akte dhe prova ku është mbështetur ajo gjykatë, në përputhje me përcaktimet e neneve 4 dhe 152 të KPP-së (*shih faqen 30 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Gjkata e Lartë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja nuk evokonin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, ndaj nuk përbënin shkak për cenimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe kërkuari kishte marrë përgjigje të arsyetuar për to nga ajo gjykatë (*shih paragrafin 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton arbitrar nga pikëpamja kushtetuese. Për më tepër, edhe jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se përsëritja e hetimit gjyqësor në apel, sipas nenit 427 të KPP-së, i nënshtrohet vlerësimit diskrecional të gjykatës së apelit (*shih vendimin nr. 55, datë 10.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, për shkak të mospërsëritjes së hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit dhe mospranimit prej saj të kërkesave të kërkuarit për marrjen e provave, është haptazi i pabazuar.

21. Në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, duke pretenduar se dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, I.P. dhe A.B., që kanë shqyrtuar rekursin e tij, kanë qenë njëkohësisht edhe pjesë e trupit gjykues të kësaj gjykate që ka shqyrtuar kërkesa të tjera të palëve gjatë hetimeve paraprake. Për këtë shkak, në datën 31.10.2025 ka paraqitur kërkesë nëpërmjet së cilës ka kërkuar dorëheqjen e tyre, pasi kishin papajtueshmëri për shqyrtimin e çështjes së tij.

22. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar

përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Po kështu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se gjykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm për faktin se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vleftësimin e masës së arrestit për të njëjtën çështje (*shih vendimet nr. 16, datë 17.02.2026; nr. 9, datë 11.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, thjesht fakti që një gjyqtar në një gjykatë penale është përfshirë edhe në vendimet që lidhen me paraburgimin për çështjen, nuk mund të justifikojë në vetvete frikën për paanshmërinë e tij, ajo që ka rëndësi është shkalla dhe natyra e këtyre vendimeve. Kur merr një vendim për paraburgimin dhe vendime të tjera paraprake të këtij lloji, gjyqtari vlerëson menjëherë të dhënat e disponueshme për të përcaktuar nëse ka baza *prima facie* për dyshimin kundër një të akuzuari për kryerjen e një vepre penale. Ndërsa kur jep vendimin në përfundim të gjykimit, ai duhet të vlerësojë nëse provat që janë paraqitur dhe debatuar në gjykatë mjaftojnë për ta shpallur të akuzuarin fajtor. Dyshimi dhe konstatimi formal i fajësisë nuk duhen trajtuar si çështje të njëjta (*shih vendimin nr. 16, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, me trup gjykues të përbërë edhe nga gjyqtarët për të cilët kërkuesi ka pretenduar njëanshmëri, në datën 24.12.2020 ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg ndaj tij, ndërsa në datat 02.04.2021, 18.05.2021, 29.06.2021 dhe 16.11.2021 ka shqyrtuar rekurset e shtetasës M.M. ndaj vendimeve të gjykatës së apelit, e cila kishte disponuar për çështjet e saj me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit personal (*vendimi i datës 02.04.2021*), marrjen në pyetje me qëllim verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” (*vendimet e datave 18.05.2021 dhe 29.06.2021*) dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal (*vendimi i datës 16.11.2021*) lidhur me akuzën “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të KP-së. Po kështu, i njëjti trup gjykues, në datën 11.12.2025, ka dhënë vendimin objekt ankimi kushtetues individual për mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit që e ka deklaruar fajtor dhe dënuar për akuzën në fjalë.

25. Pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e dy anëtarëve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë në shqyrtim nga ky kolegji, i cili, në lidhje me të, ka vlerësuar se, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 17, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, gjyqtarët I.P. dhe A.B. nuk kanë shkaqe që të heqin dorë nga gjykimi i çështjes, pasi në çështjet e referuara nga kërkuesi nuk kanë ushtruar funksionet e gjyqtarit të hetimeve paraprake ose/dhe seancës paraprake (*funksiione këto që ushtrohen vetëm nga gjyqtarët e faktit*), por funksione rishikuese për shqyrtimin e rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural. Në ato vendimmarrje gjyqtarët në fjalë nuk kanë bërë vlerësime të tilla të fakteve/provave që të krijojnë, qoftë edhe në dukje, paragjykim, në mënyrë që të plotësohen kushtet e heqjes dorë/përfundimit sipas neneve 17 dhe 18 të KPP-së, ndaj nuk kanë pengesë për shqyrtimin e rekursit të kërkuesit kundrejt vendimeve të gjykatave të faktit për zgjidhjen e çështjes penale në themel.

26. Në analizë të vendimmarrjes së mësipërme të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në vendimmarrje të ndryshme brenda të njëjtit procedim penal nuk cenon, në vetvete, kërkesën për paanshmëri. Vendimet e mëparshme të Gjykatës së Lartë kanë pasur si objekt çështje juridike që lidheshin me masat e sigurimit personal, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe të kushteve ligjore për caktimin, verifikimin ose zëvendësimin e tyre, ndërsa çështja objekt i ankimit kushtetues ka të bëjë me shqyrtimin e fajësisë së kërkuesit. Në këtë kuadër, në vendimin e saj për mospranimin e rekursit Gjykata e Lartë ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të GJJKKO-së së Apelit që ka deklaruar kërkuesin fajtor për veprën penale të akuzuar, bazuar në faktet dhe provat e administruara në gjykim, dhe jo ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se thjesht fakti që të njëjtët gjyqtarë që kanë shqyrtuar rekursin e tij kanë gjykuar edhe masat e sigurimit të caktuara ndaj tij dhe shtetases M.M. janë të pamjaftueshme në aspektin kushtetues për të justifikuar pretendimet për paanshmërinë e tyre. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument konkret që vë në dyshim paanshmërinë e këtyre gjyqtarëve në drejtim të testit objektiv dhe testit subjektiv të kësaj paanshmërie të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, si rrjedhojë e pjesëmarrjes së tyre në shqyrtimin e mëparshëm të rekurseve ndaj masave të sigurimit personal, është haptazi i pabazuar.

27. Për sa u përket pretendimeve të tjera, duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Kolegji çmon që ato të analizohen në vijim së bashku në drejtim të *parimit të prezumimit të*

pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat prima facie bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e posaçme, duke e konsideruar takimin si provë të mjaftueshme për ekzistencën e marrëdhënies korruptive, e kanë zhvendosur barrën e provës nga akuza tek i pandehuri. Në vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit nuk është cituar asnjë komunikim që të provojë që të jetë propozuar një shumë e caktuar si premtim për kryerjen e një veprimi të kundërligjshëm nga ana e kërkuesit. Po kështu, nga provat ka rezultuar se përfitimi i paligjshëm është dhënë në datën 28.07.2020, ndërkohë që GJKKO-ja e Apelit argumenton se përfitimi i paligjshëm është bërë në datën 29.07.2020. Kjo gjykatë ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme faktet, duke shmangur provat e plota kur flitet për kalim shumash monetare nga avokati te gjyqtari i çështjes. Nga përgjimi ka rezultuar se gjyqtari O.Xh. kishte marrë shumën 7.500 euro nga avokatja E.B. për të liruar klientin e saj të bashkarrestuarin A.M. dhe po e njëjta avokate, në të njëjtën mënyrë kishte marrë përsipër të lironte dhe shtetasin O.B. Pra, në rastin konkret, provat janë të qarta dhe të plota, si mekanizmi i ngjarjes nëpërmjet dhënies së parave dhe përfitimi i paligjshëm nga avokatja te gjyqtari O.Xh.

29. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e

kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 12, datë 24.08.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa i takon standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj Gjykata ka pranuar arsytimin në mënyrë të kufizuar të vendimeve të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, pasi, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuarit, Kolegji do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj tij, gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë. Po kështu, do të verifikojë nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të tij konform standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

32. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar fajtor kërkuarin për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 i KP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkuari dhe shtetasja M.M. (bashkëshortja e tij gjyqtare), në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë marrë një përfitim të paligjshëm prej 6.000 eurosh, me qëllim zbutjen e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit O.B. Në këtë marrëveshje korruptive, shtetasja M.M. ka vepruar në cilësinë e gjyqtares, ndërsa kërkuari, megjithëse jo subjekt i posaçëm, ka marrë pjesë aktivisht si bashkëshorti i saj, duke ndërmjetësuar kontaktet dhe komunikimet me të bashkëpandehurit e tjerë N.B., S.D. dhe K.Zh. Sipas gjykatës, marrëveshja është realizuar ndërmjet të pandehurve N.B., S.D. dhe K.Zh., në cilësinë e dhënësve të përfitimit

të paligjshëm, dhe kërkuesit e bashkëshortes të tij, në formën e marrjes së përfitimit të parregullt, me synim ndryshimin e masës së sigurimit nga “Arrestimi në burg” në “Garancia pasurore” për shtetasin O.B. Paratë e përfitimit të paligjshëm nga interpretimi i të gjitha provave në përputhje me njëra-tjetrën, si dhe nga vetë deklaratimet e palëve gjatë gjykimit rezultojnë që të jenë dhënë pas përfundimit të gjykimit, gjatë takimit të shtetasës M.M. me të pandehurin K.Zh., ku ajo ka marrë edhe vajzën e mitur. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, në arritjen e këtij konkluzioni ajo është bazuar në analizën/çmuarjen tërësore të provave të marra në gjykim, si përgjimet telefonike, të dhënat e vëzhgimeve të kryera, deklaratimet e palëve gjatë gjykimit (pyetja e dëshmitarëve dhe të pandehurve), të dhënat nga aktet e ekspertimit telefonik të aparatit celular të kërkuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë.

33. GJKKO-ja e Apelit, pas shqyrtimit të ankimit të kërkuesit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuesit se lirimi i shtetasit O.B. është realizuar sipas linjës së ndjekur nga avokatja e palës tjetër, shtetasja E.B., duke i paguar gjyqtarit O.Xh. shumën 7.500 euro, duke evidentuar se përgjimet e komunikimeve telefonike dhe ato ambientale, ekspertimet telefonike, si dhe vetë deklaratimet e të pandehurit S.D. dhe avokates E.B., tregojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se lirimi i shtetasit O.B. nuk është bërë duke i paguar shtetasit O.Xh. shumën 7.500 euro nëpërmjet avokates E.B. Nga tërësia e përgjimeve të kryera në kuadër të këtij procedimi penal rezultojnë se ndërmjet të pandehurit S.D. dhe avokates E.B. ka pasur komunikime të vazhdueshme me fokus datën e gjykimit dhe trupin gjykues që do të gjykonte çështjen në Gjykatën e Apelit Korçë. Po kështu, në bisedat e përgjuara rezultojnë se të pandehurit S.D. dhe N.B. referojnë se pala tjetër, duke nënkuptuar personin që mbronte avokatja E.B., kishte mbaruar punë duke i dhënë 7.500 euro gjyqtarit O.Xh., por nuk ka asnjë të dhënë në drejtim të faktit që e njëjta skemë të ketë shërbyer edhe për lirimin e shtetasit O.B. Në arritjen e konkluzionit se lirimi i shtetasit O.B. është realizuar sipas linjës së ndjekur nga të pandehurit S.D., K.Zh. dhe N.B. të shtetasja M.M, me ndërmjetësimin e bashkëshortit të saj, të pandehurit A.C., përveç sa është analizuar më sipër, në vëmendjen e GJKKO-së së Apelit ka qenë edhe e dhëna e përfituar nga biseda telefonike e datës 29.07.2020, ku i pandehuri N.B. shprehet i “ngazëllyer” te nëna e tij, shtetasja A.B., për faktin se i pandehuri S.D. nuk i ka “ngrënë në besë”, sepse nuk ishte nevojta të paguanin 1.500 euro mbi shumën 6.000 Euro që kishin paguar më parë. Po kështu, lidhur me pretendimin e kërkuesit se në rastin konkret nuk provohet kalimi i parave, si një nga elementet e domosdoshme për ekzistencën e veprës penale të korrupsionit pasiv të

parashikuar nga neni 319/ç të KP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në rastin konkret vepra penale është realizuar në formën e propozimit të një përfitimi të parregullt, sipas parashikimeve të nenit 319 të KP-së dhe nga kërkuesi dhe shtetasja M.M. në formën e pranimit të një oferte që vjen nga një përfitim i parregullt, sipas parashikimeve të nenit 319/ç të KP-së. Sipas asaj gjykate, nga tërësia e provave rezulton se shtetasja M.M., me funksion gjyqtare, mbi propozimin e të pandehurve N.B., S.D. dhe K.Zh., për dhënien e një vendimi gjyqësor në favor të shtetasit O.B., dhe nëpërmjet ndërmjetësimit/ndihmës së kërkuesit, bashkëshortit të saj, ka pranuar ofertën që vjen nga një përfitim i parregullt në shumën 6.000 euro, duke zëvendësuar masën e sigurimit “Arresti në burg” të vendosur ndaj shtetasit O.B. me “Garancia pasurore”.

34. Më tej, lidhur me shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ato janë marrë në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit dhe kanë marrë përgjigje shteruese në vendimmarrjen e asaj gjykate, me të cilën ai Kolegj ka ndarë të njëjtin qëndrim, duke mos konstatuar asnjë shkelje të karakterit ligjor nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

35. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vlerëson se gjykata e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjetër të organeve të drejtësisë”, duke analizuar për këtë qëllim përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një sërë provash, si përgjimet e komunikimeve telefonike dhe ato ambientale, ekspertimet telefonike, si dhe deklaratimet e personave që kishin dijeni për veprën penale, nga përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesit lidhur me garancitë ligjore procedurale për vlerësimin e provave. Gjykata e Lartë e ka gjetur të drejtë qëndrimin e mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit, duke u dhënë përgjigje në thelb edhe pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

36. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se në pjesën hyrëse ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe në pjesën arsyetuese shkakun se pse rekursi nuk duhej të pranohej, konkretisht

vlerësimin e Kolegjit Penal të saj, në vështrim të nenit 432 të KPP-së, për natyrën e këtyre shkaqeve. Ndonëse me arsyetim të kufizuar, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të mos ketë respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

37. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.